



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 162, datë 12.07.2021

MBI

**DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR NDRYSHIMIN E ORTAKUT  
KRYESOR TË SHOQËRISË “ALIN TRADING” SH.P.K.**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; pikës 5.2, të Kushteve të Licencës për Veprimtarinë e Tregtimit të Energjisë Elektrike, miratuar me vendim të Bordit të ERE-s nr. 97, datë 17.06.2016; si dhe nenit 15, të Rregullores për Organizimin, Funkcionimin dhe Procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 12.07.2021, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 102/3 prot., datë 06.07.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut kryesor të shoqërisë “ALIN TRADING” sh.p.k.”,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria “ALIN TRADING” sh.p.k. me NUIS L71712019T është mbajtëse e licencës nr. 380, seria T17, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 137, datë 06.09.2017.
- Me shkresën e datës 29.06.2021, protokolluar në ERE me nr. 792 prot., datë 30.06.2021, shoqëria ka kërkuar nga ERE autorizimin për transferimin e 100% të kuotave të saj (nëpërmjet dhurimit), transferim i cili ndryshon dhe ortakun kryesor shoqërisë.
- Shoqëria ka parashtruar arsyet e kësaj kërkesë, si dhe ka kërkuar mirëkuptimin e ERE-s, që nuk ka kërkuar autorizimin përpara kryerjes së procedurave ligjore për kalimin e kuotave, duke sqaruar se e ka keqkuptuar detyrimin e saj vetëm si njoftim ndaj ERE-s dhe jo si detyrim për marrjen e autorizimit. Kërkesa në ERE është bërë një ditë pasi janë kryer dhe procedurat për kalimin e kuotave. Në ligjin nr. 9723 “Për regjistrimin e biznesit”, i ndryshuar, Seksioni II, Neni 22, pika 5, parashikohet se: “Për regjistrimet e tjera të detyrueshme, përveç rasteve kur ky ligj përcakton ndryshe, aplikimi bëhet brenda 30 ditëve kalendarike nga data e ngjarjes së rrethanës faktike dhe/ose e hartimit të aktit të detyrueshëm për t’u regjistruar.”

- Shoqëria ka paraqitur të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut kryesor.
- Shoqëria “ALIN TRADING” sh.p.k. ka shlyer të gjitha pagesat rregullatore ndaj ERE-s.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut kryesor të shoqërisë “ALIN TRADING” sh.p.k., nëpërmjet dhurimit të 100% të kuotave të saj.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**